

AKT NORMATIV
Nr. 19, datë 23.4.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të pikës 9, të nenit 27, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.”.

Neni 2

Paragrafi i dytë, i nenit 36/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përjashtimisht parashikimeve të nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2020 nuk do të paguhen.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama